



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0080
Data e Vendimit: 13.02.2025

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, , si dhe nenit 17 paragrafi 6 i Rregullores së punës së OSHP-së nr. 01/2020 pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Arm Energy Group” SH.P.K. kundër vendimit të AK-së lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizimi i IEA me dru zjarri për periudhën tri vjeçare -Ritenderim” me numër të prokurimit 613-24-13138-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) –Komuna Lipjan, U.D Kryesues i Sekretariatit të OSHP-së, me datën: 13.02.2025, mori këtë:

Vendim

I. Hedhet si jo e plotë, ankesa e OE “Arm Energy Group” SH.P.K me nr. të protokollit 2025/0080, e datës 30.01.2025, e parashtruar për aktivitetin e prokurimit: “Furnizimi i IEA me dru zjarri për periudhën tri vjeçare -Ritenderim” me numër të prokurimit 613-24-13138-1-1-1, i iniciuar nga Komuna Lipjan , në cilësi të AK-së.

II. I lejohe, autoritetit kontraktues- Komuna Lipjan që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi i IEA me dru zjarri për periudhën tri vjeçare -Ritenderim” me numër të prokurimit 613-24-13138-1-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 30.01.2025, ka pranuar ankesën e OE “Arm Energy Group SH.P.K lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi i IEA me dru zjarri për periudhën tri vjeçare -Ritenderim” me numër të prokurimit 613-24-13138-1-1-1 të AK- Komuna Lipjan në cilësinë e Autoriteti Kontraktues.

Nga provat e administruara OSHP konstaton se me datën 17.12.2024, Komuna Lipjan në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë. Me datën 21.01.2025 është publikuar B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara.

Me datën 20.01.2025 OE “Arm Energy Group SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK e cila me datën 21.01.2025 ka publikuar vendimin lidhur me kërkesën për rishqyrtim të cilën e ka konsideruar si pjesërisht të bazuar.

Kundër vendimit të AK-së me datën 30.01.2025, OE “Arm Energy Group SH.P.K ka parashtruar ankesë në OSHP Nr. 2025/0080 (Nr. protokolli)

- *Vlerësimi dhe administrimi i provave* –

Pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në këtë procedurë prokurimi nga zyra e pranimit në OSHP, është konstatuar se operatori ekonomik ankues nuk ka dorëzuar dëshmi bankare për pagesën (nuk ka kryer pagesë) siç parashihet në paragrafin 2 të nenit 69 të Rregullores për prokurim publik 001/2022 si dhe nenin 118 të LPP-se.

Nga OSHP, me datën 31.01.2025, përmes email-it zyrtar të OSHP-së është kërkuar nga OE “Arm Energy Group SH.P.K që brenda afatit ligjor të dorëzojë dëshmitë (verifikimin bankar) për kryerjen e pagesës, me paralajmërimin që nëse pagesa nuk kryhet ankesa do të refuzohet. Edhe përkundër email-it me njoftim të dërguar nga OSHP, OE në fjale nuk i është përgjigjur kërkesës se OSHP-se për plotësim të ankesës- kryerjen e pagesës.

Organi Shqyrtues i prokurimit, pas të gjitha fakteve të analizuara sqaron se sipas nenit 111 paragrafi 1. 10 të Ligjit për Prokurim Publik çdo palë e interesuar mund të dorëzojë një ankesë në OSHP nëse ankesa e tillë ka dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit, të përmendur në nenin 118 të këtij ligji.

Poashtu sipas nenit 118 paragrafi 1 dhe 2 i LPP-së thuhet: “1. *Ankuesit duhet të paguajnë një tarifë të ankesave në OSHP vlera e së cilës do të përcaktohet nga KRPP-ja në legjislacionin dytësor. Dëshmia e pagesës duhet të bashkëngjitet vetë ankesës në përputhje me nenin 111 të këtij ligji. Pagesa do të bëhet në para të gatshme ose në ekuivalent të parave të gatshme në një llogari të hapur nga OSHP-ja në përputhje me Rregullat Financiare.* 2. *OSHP nuk do të pranojë ankesën nëse tarifa nuk paguhet*”.

Andaj, mbi bazën e të lartcekurave, OSHP konstaton se operatori ekonomik ka parashtruar ankesë jo të plotë siç parashihet me dispozitat e legjislacionit primar dhe sekondar dhe me Rregulloren e Punës së OSHP-së me saktësisht nenit 111 par 1.10 dhe nenit 118 par 1 dhe 2 të LPP-se si dhe nenit 69 par 2 të Rregullores për Prokurim Publik, andaj mbi bazën e këtyre dispozitave ankesa e OE “Arm Energy Group SH.P.K hedhet poshtë si jo e plotë (nuk shqyrtohet) dhe i lejohet autoritetit kontraktues – Komuna Lipjan, të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi i IEA me dru zjarri për periudhën tri vjeçare -Ritenderim” me numër të prokurimit 613-24-13138-1-1-1, përkritazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

UD. Udhëheqës i Sekretariatit, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN**
- **OE - ARM ENERGY GROUP SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: